



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 13

Prishtinë, më 9.3.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Nezir Çoçaj dhe Melihate Tërmkolli.

Munguan: Doruntinë Maloku, Fatmir Limaj dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Zahir Çerkini-praktikant në Kuvend; Avni Bytyçi, GLPS; Petrit Hysaj-OSBE; Valdet Hajdini-IKD; Behxhet Shala-KMDL NJ; Sylë Ahmeti-Kosova Sot; Adelinë Sahiti-KosovaPress; Florina Merovci-ZPRK; Senada Halimi-Zëri; Diellëza Xhemaili-KDI; Dibran Istrefi-Klan Kosova; Fitore Hajdini-ZPRK; Qëndresa Mustafa-BIRN; Valmir Klaiqi dhe Jeton Berisha-Top Chanel.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.2.2015;
3. Diskutim rreth raportit nga vizita e Komisionit në QK në Dubravë, i datës 20.2.2015;
4. Plani i Komisionit për monitorimin e Strategjisë kundër korrupsionit 2013-2017;
5. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konfliktet të armatosura jashtë territorit të vendit;

6. Diskutim lidhur me veprimet e Komisionit në raport me Agjencinë Kundër Korrupsionit, lidhur me deklarimin e pasurisë të zyrtarëve të lartë të Agjencisë;
7. Shqyrtimi i propozimit të Lidhjes së Juristëve të Kosovës për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

***Kryetarja** konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.2.2015

***Kryetarja** konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 18.2.2015, pa vërejtje.*

3. Diskutim rreth raportit nga vizita e Komisionit në QK në Dubravë, i datës 20.2.2015

Kryetarja – Më 20 shkurt 2015, Komisioni ka realizuar një vizitë në QK në Dubravë, ku u prit nga Zyrafete Imeraj, UD. drejtor i QK në Dubravë, Emrush Thaçi, drejtor i Përgjithshëm dhe Ismajl Dibrani, zëvendës drejtor për Administratë. Nga kjo vizitë Komisioni nxori këto konkluzione, siç janë:

- Nevoja për nxjerrjen e Ligjit për amnisti;
- Mosfunksionimi dhe parregullsitë e Panelit për Lirim me Kusht dhe qasja joserioze karshi shqyrtimit të kërkesave për lirim me kusht;
- Mungesa e udhëzimeve administrative në përputhje me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale që kanë të bëjnë me rendin shtëpiak;
- Mbajtja në paraburgim për një kohë të gjatë në pritje të gjykimit, si dhe vendosja e të paraburgosurve në këtë institucion, që do të duhej të ishte i ndarë;
- Mosfunksionim i institucionit të faljes;
- Moszbatimi i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale që ka të bëjë me nenin 92.9 që njeh të drejtën e shfrytëzimit të pushimit vjetor jashtë institucionit korrektues;
- Shërbimi social nuk funksionon si duhet në raport me trajtimin e kërkesave të të burgosurve;
- Mungesa e programeve të risocializimit;
- Mekanizmi i ankesave nuk funksionon;
- Mostrajtimi i kërkesave për zbatimin e ligjit më të favorshëm për personat e dënuar sipas kodit të vjetër penal;
- Trajtimi joadekuat shëndetësor në raport me gjendjen e tyre, si dhe lirimi për trajtim i përzgjedhur jashtë qendrës;

- Nevoja për rishikimin e memorandumit të lidhur në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, që ka të bëjë me trajtimin shëndetësor të të burgosurve jashtë qendrës korrektuese;
- Bastisje të shpeshta për të burgosurit, jo edhe për stafin që është pika që ndihmon futjen e gjërave në këtë institucion.

Ajo, gjithashtu, i njoftoi se ka pranuar një shkresë tjetër nga një dëshmitar i mbrojtur brenda QK-Dubravë dhe ka kërkuar nga Komisioni për Legjislacion që sa më shpejt të jetë e mundur të realizojë edhe një vizitë në Pavijonin D. Ajo çka më ka shqetësuar është fakti se kur e kam pranuar letrën, ajo ka qenë e hapur, pra kur është sjellë te unë, ka qenë zarfi i hapur dhe kjo lë të nënkuptojë se stafi i QK-së e ka lexuar këtë letër, gjë që konsideroj se është e padrejtë edhe duke e ditur faktin që është adresuar në një institucion të Republikës së Kosovës, pra në Komisionin për Legjislacion.

Armend Zemaj – Është mirë që pas një kohe të gjatë ka arritur të realizohet një vizitë në QK në Dubravë, si qendra më e madhe, dhe se është parë edhe njëherë se mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve nga ana e Kuvendit është e nevojshme, ngase e kemi edhe detyrë. Duke e ditur rëndësinë e vizitës, propozoi që të vizitohen edhe qendrat tjera, duke e ditur se ka kërkesa, kjo edhe me vetë faktin se ju (kryetare), veç se e keni pranuar edhe një letër, andaj do të ishte padrejtësi nëse nuk i vizitojmë edhe qendrat tjera. Konsideroj se mungesa e akteve nënligjore lejon zbrazëtira të tjera ligjore për moszbatim të legjislacionit në fuqi. Në rrjedhë të diskutimit që po bëjmë, propozoj që në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të thërrasim Panelin për Lirim me Kusht dhe të shohim mënyrën e zbatimit të ligjeve nga ana e tyre. Është joserioze nga ana e Kuvendit, nëse ne e lëmë këtë institucion pa mbikëqyrje, por gjithmonë duke pasur kujdes që mos të cenohet pavarësia e tij. Mendoj se kjo është arsye edhe e mosfunksionimit në zinxhir të institucioneve, ngase patëm ankesa edhe për shërbimin social, për mosfunksionim të rregullt me çështjen e shkresave, dhe duke qenë neglizhentë në përgatitjen e dokumentacionit dhe shqyrtimin e lëndëve, shumë të dënuar kanë mbetur pa përfituar nga e drejta për t'u liruar me kusht dhe kjo mund të jetë e rrezikshme, ngase ndikon negativisht në procesin e risocializimit dhe mund të sjellë probleme në shoqëri. Çështje tjetër me rëndësi që ka dalë nga vizita në QK në Dubravë, është edhe mosfunksionimi i institucionit të faljes. Gjithashtu, kemi vërejtur se në lidhje me amnistinë, të burgosurit nga vizitat e mëhershme dhe nga bërja e politikave të ndryshme, janë vënë në lajthitje duke shpresuar se do të përfshihen të gjithë, por me anë të vizitës sonë, ne iu kemi bërë me dije se kjo nuk mund të ndodhë, ngase për t'u arritur ajo, duhet plotësuar disa kriterë ligjore. Një propozim tjetër tek rekomandimet, mendoj se do të ishte i nevojshëm, sipas të cilit të përmirësohen kushtet e punës për stafin e QK-së dhe të gjendet një përkrahje shtesë për ata. Duke e bërë një gjë të tillë, konsideroj se eliminojmë shumë keqpërdorime, ngase puna e tyre është e ndjeshme dhe se mund të ketë ndikime nga brenda ose jashtë qendrës dhe si pasojë të mos kemi një trajtim të barabartë apo të duhur. Sidomos përkrahje të veçantë të marrin njësitet

që kanë punën me rrezikshmëri më të lartë. Dhe për fund, besoj se duhet të bëhet edhe një vizitë tjetër, në mënyrë që t'i marrim parasysht edhe kërkesat e tjera që nuk i kemi deri më tani.

Kryetarja – Arsyeja se pse nuk janë vizituar pavijonet e tjera, është vetëm për shkak të kohës, andaj unë e mbështes kërkesën që të vizitohen edhe pavijonet tjera. Ndërsa gjetjet që i kemi nga vizita e kaluar, nuk do të thotë që janë vendimtare, ngase jam e bindur se ka pasur edhe kërkesa tjera, por nuk kanë mundur të na tregojnë as të burgosurit, e as të paraburgosurit, ngase gjatë kohës së vizitave, stafi ka qenë gjithnjë bashkë me neve dhe konsideroj se frika e tyre nga ana e stafit e ka bërë të pamundur që të shprehen edhe pakënaqësitë tjera. Sa i përket Panelit për Lirim me Kusht, i cili funksionon në kuadër të Këshillit Gjyqësor, edhe unë jam për atë që të thirret e të na informojë, e jo raport që mos të shihet si ndikim në lidhje me rastet që dalin para tij. Sa i përket Ligjit për amnisti, konsideroj se ka ardhur koha që nëse nuk e bën procedimin në Kuvend Ministria e Drejtësisë, atë ta bëjë Komisioni për Legjislacion. Ndërsa, kur jemi te kontrabanda brenda qendrës, konsideroj se ajo bëhet vetëm në bashkëpunim me stafin, ngase në të kundërtën është parë se është e pamundur të hyhet me diçka brenda.

Melihate Tërmkulli – Theksoi se pavarësisht faktit se të burgosurit janë individë që kanë kryer vepra penale, ata duhet të trajtohen në mënyrë humane dhe se është plotësisht e papranueshme që ta kenë një trajtim jo të mirë, p.sh mos të kenë ndihmë shëndetësore të duhur. Konsideroj se duhen bërë hapa më ndryshe për të rregulluar këtë gjendje, dhe se nuk është i vetmi segment që ka problem me zbatimin e ligjit. Pakënaqësitë janë të vazhdueshme në burgje, ngase herë pas here na vijnë informata nga brenda, por e keqja është se nuk kem dëshmi, ato mungojnë, andaj çdo gjë që ndodh, ndodh me bashkëpunim me stafin. Andaj rekomandoj që të gjitha këto pakënaqësi ne t'i dërgojmë në adresa përkatëse, dhe për një periudhë të caktuar, të kërkojmë raport se çfarë është ndërmarrë drejt përmirësimit të gjendjes, zbatimit të rregullave dhe kthimit të ligjshmërisë në këto institucione.

Selvie Halimi – Theksoi se nevoja për të nxjerrë Ligjin për amnisti është evidente dhe duhet të kontaktojmë me Ministrinë e Drejtësisë dhe të marrim ndonjë informacion se a kanë filluar të punojnë në këtë drejtim apo ne të marrim nismën për një gjë të tillë. Propozimi për thirrjen për bisedim me Panelin për Lirim me Kusht është i mirëseardhur, ngase kemi nevojë të dimë se përse nuk po funksionin ky panel, pse ka parregullsi, mos ndoshta po punon në mënyrë të njëanshme? Pse mungon udhëzimi administrativ për rendin shtëpiak, kur ligjet janë në fuqi, besoj se është tjetër problem. Mbajtja për një kohë të gjatë në paraburgim paraqet tjetër problem dhe duhet ditur arsyen e pritjes. Shqetësime tjera janë edhe mosfunksionimi i institucionit të faljes dhe ai i ligjit për zbatimin e sanksioneve penale, konkretisht neni që flet për pushimin vjetor në shtëpi. Gjithashtu, mendoj se duhet ditur se çka po iu mungon të burgosurve nga ana e shërbimit social dhe pse nuk funksionon mekanizmi i ankesave. Zbatimi i ligjit më të favorshëm konsideroj se duhet të bëhet, ngase edhe iu takon. Shqetësim tjetër konsideroj se është trajtimi mjekësor jashtë qendrës, prandaj duhet ditur se a ka raste që pa kurrfarë lidhje dërgohet ndonjë i

burgosur jashtë qendrës, dhe nëse ka, cilat janë ato. Çështje tjetër është edhe mosfunksionimi i memorandumit të bashkëpunimit në mes Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Shëndetësisë, cilat janë ato pika që e bëjnë të pamundur zbatimin e tij. Sa i përket bastisjeve, konsideroj se ajo duhet të jetë e rastit, e jo vetëm një ditë të caktuar, ngase nëse e kemi një orar që dihet se do të vijë koha për kontroll, është e vështirë të zihen gjërat e kontrabanduara dhe që janë të ndaluara brenda qendrës, ngase ato mund të fshehën diku. Në fund, konsideroj se raporti duhet të jetë më shumë i plotësuar me të dhëna dhe ato të jenë jo vetëm nga ana e të burgosurve, por edhe gjetje që dalin nga vet institucionet, ngase vetëm në këtë mënyrë do të kemi një raport të plotë dhe me fakte nga të dy palët.

Agim Aliu – Theksoi se me vetëm një vizitë është e pamundur që të konstatohen të gjitha pakënaqësitë e të burgosurve, por edhe të sqarohen të gjitha shqetësimet që i ka publiku në lidhje me atë se çfarë është thënë përkitazi me kushtet e të burgosurve. Ky raport na shërben që të ndajmë çështjet dhe të dimë se çfarë të veprojmë dhe se cilat janë më me prioritet për t’u rregulluar, ndërsa atyre dytësore t’u qasemi me mekanizma të ndryshëm apo me hartimin e planave të veprimit për të zgjidhur problemet e caktuara. Në këtë rrjedhë të diskutimit, konsideroj se janë tri çështje që duhet dhënë prioritet për trajtim. E para ka të bëjë me Ligjin për amnisti, gjë që unë mendoj se jo gjithçka në lidhje me këtë duhet diskutuar në nivele politike, por kjo duhet të shihet edhe me humanizëm, që gjatë hartimit të tij, vërtet të krijohet një i tillë që t’i shërbejë qëllimit për nxjerrjen e tij dhe asaj se për çfarë ne e kemi vizituar QK në Dubravë. Çështja e dytë ka të bëjë me Panelin për Lirim me Kusht dhe konsideroj se duhet të ftohet ky institucion dhe ta kemi të qartë se çfarë është duke ndodhur me mos shqyrtimin racional të kërkesave për lirim. Dhe çështja e fundit primare, konsideroj se ka të bëjë me institucionin e faljes. Kur jemi te kjo çështje, mendoj se nuk duhet të mbetemi peng i së kaluarës, ngase do të ishte e padrejtë që në emër të gabimeve që janë bërë, mos të paragjykoen rastet që vijnë, dhe në këtë mënyrë, të privohen nga përfitimi i faljes individë që me të vërtetë e meritojnë një gjë të tillë. Ndërsa shqetësim tjetër alarmues që është adresuar, është edhe nepotizmi i pranishëm në stafin brenda qendrës dhe kjo është adresuar edhe nga mekanizma të tjerë, pra nuk është diçka e re, por shpresojmë që me iniciativën që ka marrë z.Thaçi, si drejtor i Përgjithshëm i Qendrës, sadopak të sanohet gjendja ekzistuese.

Nezir Çoçaj – Unë pajtohem me gjetjet që përshin raporti që ka dalë nga vizita jonë në QK në Dubravë, por konsideroj se është e rëndësishme dhe pajtohem me atë që të vizitohet edhe Pavijoni D, dhe jo vetëm aq. Propozoj që të vizitohen edhe qendrat e tjera korrektuese në Kosovë, dhe në këtë mënyrë, pas gjetjeve, sa më shpejt të reflektohet në drejtim të përmirësimit të gjendjes së krijuar. Vlen të thuhet se nepotizmi në qendrën që ne ishim, ishte shumë i theksuar, kishte babë dhe bir dhe familjarë të tjerë, andaj kjo nuk është e mirë dhe nuk i shërben çështjes. Andaj, do të ishte mirë që në raportin përfundimtar të jemi shumë konkret. Shqetësues ishte edhe fakti që kishte shumë individë që ishin për një kohë të gjatë në paraburgim, për shumë vite të tëra

dhe konsideroj se nuk ishte aspak në rregull një gjë e tillë, andaj duhet bërë diçka në këtë drejtim që mos të ndodhin raste të tilla.

Agim Ademaj – Raporti duhet të jetë më i plotë dhe kjo mund të arrihet pas vizitës që do t'i bëjmë edhe pavijoneve dhe qendrave të tjera korrektuese, dhe pas kësaj, të paraqesim në seancë një raport të kompletuar dhe të përgjithësuar, me të gjitha problemet. Duhet të grupohen rekomandimet që u thanë dhe të drejtohen te institucionet përkatëse. Unë jam i interesuar që t'i ftoj aktorët përkatës dhe të informohemi më gjerësisht. Mendoj se çështja e amnistisë paraqet defektin kryesor, andaj duhet të drejtohem tek institucionet përkatëse që të marrim informacion se çka është duke ndodhur.

Danush Ademi – Parashtroi pyetjen në lidhje me atë se në këtë qendër ka të burgosur edhe nga radhët e komuniteteve, andaj është e rëndësishme të dihet se si janë sjelljet ndaj pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë, a trajtohen ata në mënyrë të barabartë apo ka ndonjë diskriminim karshi tyre.

Kryetarja – Në përgjigjen në lidhje me pyetjen e parashtruar nga z.Ademi, theksoi se gjatë vizitës nuk janë bërë dallime sa i përket trajtimit të komuniteteve jo-shumicë dhe se gjatë qëndrimit atje nuk kemi hasur në ndonjë vërejtje të këtij karakteri. Të gjitha ankesat kanë qenë të përbashkëta dhe janë paraqitur në raport, pra nuk ka pasur ankese në lidhje me diskriminime në baza të etnisë.

Armend Zemaj – Propozoj që të vizitohet edhe Qendra Korrektuese në Lipjan, duke e ditë se në atë institucion janë të vendosur të miturit, si dhe gjinia femërore, në mënyrë që të kemi një raport më të përgjithësuar për të gjitha qendrat. Si përfundim, mund të themi se problemi kryesor për të gjitha këto parregullsi, konsiston në atë se shkalla në funksionimin e zinxhirit institucional, nuk funksionon, andaj pa u rregulluar kjo çështje, nuk mund të presim një funksionim të rregullt në proceset tjera. Gjithashtu, në lidhje me ato që u thanë më lart, dua të jem më konkret, ku kemi hasur raste se ka 7 apo 8 vite në paraburgim, duke pritur një vendim final gjyqësor. Andaj, konsideroj se është shumë e rëndësishme që të bëhen edhe këto vizita që të kemi një pasqyrë reale të gjendjes. Dhe, çështja e fundit që do ta ngre, ka të bëjë me memorandumit e bashkëpunimit në mes të MD-së dhe MSH-së, ku ka raste që mund të keqpërdoren, pra të përcaktohet një sëmundje tjetër nga mjekët brenda qendrës, ndërsa ndryshe të caktohet jashtë qendrës, andaj është mirë që të kërkojmë një funksionim më të mirë edhe në këtë aspekt.

Melihate Tërmkolli – Duke u ndërlidhur me diskutimin që është zhvilluar më lart, theksoi se e përveç idesë për t'u ftuar institucionet përkatëse dhe vizitave në qendrat e tjera korrektuese, e që i përkrah plotësisht, propozoi që për këtë çështje të zhvillohet edhe një debat në Kuvend.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi që të bëjë edhe një vizitë në QK në Dubravë, si dhe në QK në Lipjan.

4. Plani i Komisionit për monitorimin e Strategjisë kundër korrupsionit 2013-2017

Kryetarja theksoi se strategjia si dokument, është votuar në mandatin e kaluar, pavarësisht kundërshtimeve nga opozita e atëhershme dhe nga shoqëria civile. Tani kemi një draft të hartuar, por në mbledhjet në vazhdim, do të shqyrtohet nga anëtarët e Komisionit, pasi t'u shpërndahet atyre. Meqë znj. Tërmkolli është pjesë e Komisionit si deputete, nuk e di a jeni përfaqësuese e LDK-së, apo, po vetëm nuk keni të drejtë vote.

Melihate Tërmkolli – Qysh si deputete? Mua më erdhi keq edhe në fillim kur më prezantove. Unë jam anëtare e barabartë si të gjithë deputetët këtu.

Kryetarja – LDK-ja i ka tre përfaqësues në Komisionin për Legjislacion. Ende nuk ka vendim zyrtar.

Armend Zemaj – Ju është lexuar emri që ka dalë në LDK.

Kryetarja – Është në LDK, po patjetër, por jo në Komisionin për Legjislacion.

Melihate Tërmkolli – Mirë, mirë, deri në momentin kur ndërrohet në Kuvend, bëhet një anëtar i ri i AAK-së, unë jam këtu, këtu më keni.

Kryetarja – Nuk keni të drejtë vote znj. Tërmkolli!

Melihate Tërmkolli – Qysh nuk kam?

Kryetarja – Ti je në LDK, nuk përfaqëson Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës.

Kryetarja – Jemi deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që përfaqësojmë subjekte politike. Unë nuk kam asgjë kundër teje, vetëm po të tregoj që në mbledhjet e Komisionit për Legjislacion, ta garanton edhe Kushtetuta edhe Rregullorja e Punës që ti të jesh e pranishme. Mirëpo, je pa të drejtë vote.

Melihate Tërmkolli – Edhe të PDK-së bile më kanë votuar, veç të Vetëvendosjes jo. Zonjë, unë nuk jam veç deputete, deputete ishte veç Margarita kur vinte.

Kryetarja – Edhe ajo ka qenë në PDK, ka dalë mandej deputete e pavarur. Është e njëjtë. Ajo ka dalë deputete e pavarur, ti ke dalë në LDK, është e njëjtë.

Melihate Tërmkolli – Oj vajzë, kuptoji sendet mirë!

Kryetarja – T'u kisha lutur të kesh kujdes sesi shprehesh në mbledhje të Komisionit për Legjislacion, sepse disa herë po përsëriten të njëjtat gjëra.

Melihate Tërmkolli – Oj ti vajzë, sërish po të them, kujdes me rregullat!

Kryetarja – A e përfundove?

Melihate Tërmkolli – Rregullat institucionale duhet respektuar.

Kryetarja – A e përfundove?

Melihate Tërmkolli – Po.

Kryetarja – Faleminderit!

Pas diskutimit të zhvilluar më lart, ajo vazhdoi duke propozuar shqyrtimin e draftit të Strategjisë 2013-2017 kundër korrupsionit që inkorporohet nga Presidenca e Kosovës, në kuadër Këshillit Kundër Korrupsionit, Agjencia Kundër Korrupsionit, Prokuroria, përfaqësuesit e gjykatave, shoqëria civile, doganat, Policia e Kosovës, si dhe drejtuesin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, z.Hasan Preteni. Mirëpo, grupi punues për monitorimin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, ende nuk është funksionalizuar, sepse disa subjekte politike nuk i kanë deleguar deputetët e tyre në këtë grup punues, siç është rasti i AAK-së, dhe derisa të funksionalizohet ky grup, kjo kompetencë për monitorim i takon Komisionit për Legjislacion.

Komisioni vendosi që plani i veprimit të shqyrtohet dhe të miratohet në një takim të radhës.

1. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konfliktet të armatosura jashtë territorit të vendit

Kryetarja – Theksoi se subjekti politik që i takon, ka paraqitur 8 amendamente në lidhje me këtë projektligj dhe po të njëjtat nuk janë përkrahur nga Komisioni Funkcional për Punë të Brendshme, por që do të tentojmë që ato t'i paraqesim në seancë. Ajo potencoi se si subjekt politik janë fuqishëm kundër pjesëmarrjes së shqiptarëve në luftën e Sirisë, por është e rëndësishme që institucionet e Kosovës t'i listojnë organizatat terroriste, t'i shpallin si të tilla, dhe më pas, përmes mekanizmave ligjorë, të luftojmë aktivitetin e tyre brenda Kosovës. Këtu kemi vetëm një amendament, ai është i propozuar nga deputeti Zafir Berisha, por ne nuk kemi mundësi që ta përkrahim ose jo, por ne vetë e votojmë raportin si të tillë.

Atëherë, kush është për miratimin e raportit për Projektligjin nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konfliktet të armatosura jashtë territorit të vendit? Kemi 6 vota për, 1 kundër, ndërsa abstenim nuk ka.

Melihate Tërmkolli – Shtatë vota për, një votë kundër.

Kryetarja – Gjashtë vota për, një votë kundër dhe asnjë abstenim. U votua ky raport.

Melihate Tërmkolli – Zonja kryetare,...të lutem ti po lyp korrektësi dhe jam shumë dakord. Po të lus shumë për seriozitet, me të njëjtën mënyrë, nuk janë 6 vota për, por janë shtatë vota për.

Më fal, në momentin kur në seancë caktohet anëtari i AAK-së, unë nuk jam anëtare e këtij Komisioni. Beso, nuk po më vjen fort mirë që jam në këtë pozicion, fare nuk po më vjen mirë. Sot i luta të Aleancës që sa më shpejt ta kryejnë këtë proces. Nuk është krejt punë ndërgjegjeje, por është punë rendi. Se për ndërgjegje kisha dalë atë ditë, nuk kisha ndenjur asnjë ditë më shumë, por është punë rendi institucional, prandaj të lutem respektoje.

Kryetarja – Faleminderit zonja Tërmkolli edhe një herë. Komisioni për Legjislacion ka gjithsej njëmbëdhjetë anëtarë, tre anëtarë nga LDK-ja dhe nga subjektet tjera, LDK-së nuk i lejohet që t'i ketë katër, vetëm tre kanë të drejtë vote, edhe të tjerët kanë të drejtë të marrin pjesë, por pa të drejtë vote. AAK-ja ka të drejtën e propozimit të një anëtari në këtë Komision. Interpretimi im është ky.

Melihate Tërmkolli – Interpretimi im është institucional dhe po më vjen keq, po nuk është ashtu. Nuk po dua të bëj temë. Nuk ke të drejtë, besomë!

Kryetarja – Atëherë 6 vota për, 1 votë kundër, asnjë abstenim.

Melihate Tërmkolli – Më fal, unë dua që kjo të regjistrohet në procesverbal. Shtatë vota për, një kundër.

Pas diskutimeve, Komisioni me shumicë votash, nxori këtë

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konfliktet të armatosura jashtë territorit të vendit dhe amendamenti i propozuar, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamenti i propozuar, mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Diskutim lidhur me veprimet e Komisionit në raport me Agjencinë Kundër Korrupsionit, lidhur me deklarimin e pasurisë të zyrtarëve të lartë të Agjencisë

Kryetarja – Diskutoj në lidhje me atë se Agjencia Kundër Korrupsionit, sipas ligjit në fuqi, ka dalë me deklaratë publike që i fton të gjithë zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës që t'i deklarojnë pasuritë e tyre, më së voni, deri më 31 mars. Por, këtë nuk e ka paraparë edhe për zyrtarët e saj, andaj, kërkojmë nga Agjencia Kundër Korrupsionit që deklaratat financiare të zyrtarëve të Agjencisë Kundër Korrupsionit të na i sjellin para 31 marsit, ngase ne si Komision që e mbikëqyrim punën e këtij institucioni, kemi të drejtë ta bëjmë këtë. Arsyeja pse po kërkojmë që këto deklaratat të raportohen më herët është, sepse këta zyrtarë duan që pasuritë e tyre t'i raportojnë më vonë. Kjo është një standard i dyfishtë dhe shkelje e ligjit.

Pas diskutimeve, Komisioni me shumicë votash, nxori këtë

Përfundim

Komisioni, duke marrë parasysh afatin e rregullt ligjor për deklarimin e pasurisë dhe obligimin e Komisionit për Legjislacion, sipas nenin 14 paragrafi 1.6, vendosi që të kërkojë nga Agjencia formularët e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë për vitin 2015.

7. Shqyrtimi i propozimit të lidhjes së Juristëve të Kosovës për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Kryetarja – Lidhja e Juristëve të Kosovës propozon emërimin për anëtarë të Këshillit Drejtues, z. Mazllum Baraliun për anëtar në Institutin Gjyqësor të Kosovës. Ky është anëtari i fundit që Kuvendi duhet ta emërojë. A jeni për procedim në Kuvend?

Selvie Halimi – Është konflikt interesi që z. Mazllum Baraliu, të jetë anëtar në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, sepse z. Baraliu, para 6 muajve, ka qenë kandidat i një subjekti politik.

Kryetarja – Ku është konflikt interesit?

Selvie Halimi – Është konflikt interesi, se nuk mund të jetë i paanshëm apo objektiv në marrjen e vendimeve.

Kryetarja – E gjyqtarin që e dërguat në Këshillin Gjyqësor?

Melihate Tërmkolli – Këtë anëtar na ka sjellë Lidhja e Juristëve të Kosovës, konflikt i interesit nuk është.

Armend Zemaj – Duhet të jemi në përputhje me ligjin. Sipas një ligji për ndërmarrjet publike, nuk mund të jetë 36 muajt e fundit në pozitë politike, por z. Baraliu nuk është në pozitë politike, kështu që Albulenë duhet të na informosh se a është në ndonjë kryesi të Lëvizjes Vetëvendosje. Në rast se nuk është, duhet ta dërgojmë në seancë plenare që të votohet.

Selvie Halimi – E respektoj z. Baraliun, por e diskutova çështjen e konfliktit të interesit, që mos të kemi ndonjë ndërlikim.

Nezir Çoçaj – Në këtë pikë kërkoj më shumë anëtarë nga Lidhja e Juristëve të Kosovës, sepse konsideroj se mund të jetë presion që të jetë pa kundërkandidat, z. Baraliu.

Agim Aliu – Situatat e tilla të krijuara janë faktor tregues edhe për gjendjen e vendit në përgjithësi. Kjo ngase kohëve të fundit jemi duke u ballafaquar me një riciklim figurash kur kemi të bëjmë me zgjedhjen e anëtarëve të ndryshëm nëpër institucione të ndryshme dhe është krijuar përshtypja se nuk ka në Kosovë individë të tjerë të zotë, për të kryer detyra të caktuara.

Agim Ademaj – Lidhur me këtë pikë, theksoi se duhet të ketë më shumë transparencë rreth propozimeve.

Pas diskutimeve, Komisioni në mënyrë unanime, nxori këtë

R e k o m a n d i m

Të emërohet anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, kandidati:

I. Mazllum Baraliu- anëtar nga Shoqata e Juristëve të Kosovës.

II. Mandati i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, zgjat 2 (dy) vjet.

9. Të ndryshme

Kryetarja – Ka diskutuar çështjen për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka votuar për tre anëtarë për këtë Këshill. Unë kam drejtuar një letër tek Prokurori Disiplinor, për sqarim për këta anëtarë se a janë nën hetime. Në letrën që kam pranuar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor, konfirmon që gjyqtari Armend Berisha është duke u hetuar për shkelje disiplinore nga Gjykata Themelore në Pejë. Mirëpo, gjyqtari Nehat Idrizi dhe gjyqtari Xhymshit Baralushi, nuk janë nën hetime. Andaj, konsideroj se është degradim për Këshillin Gjyqësor dhe e pahijshme, shqetësuese që Kuvendi të miratojë individë që janë nën hetime. Andaj, kërkoj që në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit, të shkarkohet z.Berisha nga detyra.

Çështja tjetër që u diskutua, kishte të bënte me dy kandidatë për anëtarë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, sepse një anëtar nga komuniteti serb duhet të zgjidhet, dhe gjithashtu, edhe një anëtar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, me qëllim të plotësimit të vendeve boshe në këtë institucion. Në këtë rrjedhë të diskutimit, ne kemi kërkuar nga Oda e Avokatëve që të dërgojë më shumë se një emër si propozim për anëtar të KGJK-së, mirëpo kjo kërkesë nuk është marrë parasysh dhe nga i njëjti institucion është thënë se vetëm z.Dobruna është kandidat për atë pozitë.

Armend Zemaj – Theksoi se duhet ditur qartë nga ana e Prokurorit Disiplinor se z.Berisha a është duke u hetuar dhe për çfarë është duke u hetuar, ngase nuk dëshiroj që Kuvendi të marrë një vendim, tash për shkarkim, që do të pasqyrojë një joseriozitet dhe papërgjegjshmëri me vendimet e tij. Andaj, konsideroj se është e rëndësishme, që para se të merren vendime të rëndësishme, të kemi në detaje informacion në lidhje me atë çka u tha më lart.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu
